

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6883
E shtunë, 29 prill 2023
Çmimi 0.40 €

Certifikohen rezultatet zgjedhore për kryetarë të katër komunave në veri



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

BASHKIMI EVROPIAN (BE) KONFIRMON AGJENDËN E TAKIMIT TË 2 MAJIT NË MES TË KRYEMINISTRIT TË KOSOVËS ALBIN KURTI DHE PRESIDENTIT TË SERBISË, ALEKSANDËR VUÇIQ

ASOCIACIONI DHE DEKLARATA PËR TË PAGJETURIT, NË AGJENDËN E TAKIMIT TË 2 MAJIT



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të diskutojnë më 2 maj në Bruksel për deklaratën e të pagjeturit dhe për draftin e parë të statutit të Asociacionit të Komunave me

Shumicë Serbe. Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka bërë me dije se pas trajtimit të këtyre dy temave, do të shihet se a mund të diskutohet edhe për çështje të tjera në interes të dy vendeve. Çështja e Asociacionit të

Komunave me Shumicë Serbe është hapur si temë edhe të enjten në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në të cilin i është bërë thirrje Kosovës që sa ma shpejt të themelojë këtë asociacion

AKTUALE



KOSOVA SHËNON DITËN E TOKËS, OSMANI KËRKON ANGAZHIM TË INSTITUCIONEVE F.6

KUVENDI KOMUNAL I MITROVICËS SË VERIUT KËRKON HAPJEN E URËS MBI IBËR, REAGJONË VUÇIQI DHE LISTA SERBE F.5

TOGERI I FSK-SË, YLLI DALLADAKU, NDEROHET ME ÇMIMIN "INTERNATIONAL HONOR GRADUATE" NË SHBA F.7

ATRC-JA KËRKON NGA MSH-JA HARTIMIN E LISTËS SË SËMUNDJEVE PROFESIONALE F.6

EKONOMI



PROTESTOJNË PUNËTORËT E KEK-UT, KËRKOJNË RITJE TË PAGAVE F.8

MIELLI LIROHET, BUKA JO F.8

SPORT



DRITA PËRBALLET ME FERIZAJN, VAVALIS SYNON TË DEBUTOJË ME FITORE F.10

IKD-ja: KUVENDI U INJORUA NGA QEVERIA, DEPUTETËT E PUSHTETIT I BOJKOTUAN SEANCAT

F.3



ISH-MINISTRJA DHURATA HOXHA LIROHET NGA AKUZA PËR KORRUPSION

F.5



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Erdogani nuk del në fushatë zgjedhore për të tretën ditë



ANKARA, 28 PRILL - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, i ka anuluar paraqitjet në fushatën e zgjedhjeve për të tretën ditë radhazi, pasi është sëmurë. Zyrtarët e kanë përshkruar sëmundjen e tij si infeksion intestinal. Erdogan është duke kërkuar një mandat të tretë presidencial në zgjedhjet e 14 majit në Turqi. Ai duhet të shfaqet në një hapje ure dhe një tubim politik në qytetin jugor të Adanas, por orari i tij ka ndryshuar për të treguar se do të merrte pjesë në

ceremoninë e hapjes përmes videolidhjes. Erdogan është sëmurë gjatë një interviste televizive të martën. Tubimet e tij zgjedhore të planifikuara për të mërkurën dhe të enjten ishin anuluar. Ai dukej i zbehtë të enjten teksa ka inauguruar një termocentral bërthamor përmes videos në daljen e tij të parë publike që nga sëmundja. Zyrtarë të tjerë janë përpjekur t'i largonin shqetësimet për shëndetin e udhëheqësit 69-vjeçar përpara zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare të muajit të

ardhshëm. Sondazhet e fundit kanë treguar një epërsi të lehtë për sfiduesin kryesor të Erdoganit në mes të një rënieje ekonomike dhe një tërmeti që në shkurt kishte lënë të vdekur më shumë se 50 mijë njerëz. Erdogan, i cili i është nënshtruar një operacioni në zorrë në vitin 2011, ka drejtuar Turqinë që nga viti 2003, fillimisht si kryeministër dhe si president që nga viti 2014. Ai ka bërë fushatë të fortë javët e fundit, duke marrë pjesë në disa ngjarje në të gjithë vendin çdo ditë, raporton "AlJazeera".

Armëpushimi zgjatet, luftimet në Sudan nuk pushojnë

KARTUM, 28 PRILL - Ushtria dhe një grup paramilitar në Sudan janë pajtuar ta zgjasin marrëveshjen e armëpushimit disa orë para se armëpushimi paraprak prej 72-orësh të skadonte.

Zgjatja e armëpushimit edhe për 72 orë vjen pas përpjekjeve intensive diplomatike nga shtetet fqinje, por edhe nga Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe Kombet e Bashkuara. Por, pavarësisht prej armëpushimit, në kryeqytetin sudanez Kartum luftimet e ashpra po vazhdojnë. Armëpushimi paraprak mundësoi largimin e mijëra personave, teksa disa shtete vazhduan përpjekjet e tyre për evakuimin e qytetarëve të tyre. Pothuajse dy javë luftime të ashpra midis ushtrisë dhe një grupi paramilitar kanë lënë të vdekur qindra persona. Në Sudan po luftojnë ushtria dhe grupi paramilitar i Forcave të Mbështetjes së Shpejtë.

Sudani Jugor ka ofruar t'i ndërmjetësojë bisedimet e paqes dhe ushtria sudaneze është pajtuar të dërgojë përfaqësues në këto bisedime. Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha se Uashingtoni "në mënyrë shumë aktive" ka punuar për zgjatjen e



armëpushimit, duke shtuar se, pavarësisht se armëpushimi i parë nuk u respektua plotësisht, ai mundësoi uljen e dhunës. Por, zëdhënësjë e Shtëpisë së Bardhë, Karine Jean-Pierre, më vonë tha se situata mund të përkeqësohet. Ndërkaq, Forcat e Mbështetjes së Shpejtë dhe dëshmitarët thanë se ushtria ka sulmuar pozicionet

e grupit paramilitar në Kartum. Të paktën 512 persona janë vrarë në luftime që nisën më 15 prill dhe pothuajse 4 200 të tjerë janë plagosur, edhe pse numri real i viktimave mund të jetë shumë më i lartë. Dhuna shpërtheu fillimisht në kryeqytet, Kartum, midis fraksioneve rivale ushtarake, që po luftojnë për kontrollin e Sudanit – shtetit të

tretë më të madh në Afrikë. Që nga grushtshteti i vitit 2021 Sudani është udhëhequr nga këshilli i gjeneralëve në krye me dy ushtarakët që aktualisht po luftojnë: gjenerali Abdel Fattah al-Burhan, që është kreu i forcave të armatosura dhe presidenti i shtetit, dhe zëvendësi i tij, gjenerali Mohamed Hamdan Dagalo, që udhëheq Forcat e

Mbështetjes së Shpejtë. Dy gjeneralët kanë mospajtime lidhur me mënyrën se si shteti do të shkojë drejt sundimit civil. Mosmarrëveshjet kryesore në planin për trazicion kanë të bëjnë me përfshirjen e 100 mijë anëtarëve të Forcave të Mbështetjes së Shpejtë në ushtrinë e rregullt, dhe se kush do ta udhëheqë ushtrinë e re.

"Digjet" Spanja, temperaturat arrijnë 38 gradë

MADRID, 28 PRILL - Një valë ekstreme e të nxehtëtë ditët e fundit e ka goditur Spanjën. Ky shtet po përjeton temperatura që zakonisht regjistrohen vetëm gjatë pikut të verës. Meteorologët kanë deklaruar se termometri ka shënuar 38 gradë celsius, vlerë kjo që konsiderohet më e larta ndonjëherë për muajin prill. Ekspertët kanë bërë me dije se

bëhet fjalë për një masë të nxehtë ajri nga Afrika që ka pushtuar Spanjën, që pritet të zgjasë për disa ditë. Temperaturat në Sevilla kanë arritur në 37 gradë celsius, por pritet të arrijnë një kulm prej 40 gradësh celsius në luginën jugore Guadalquivir. Për këtë arsye, autoritetet kanë vendosur të marrin masa të menjëhershme duke bërë që

edhe shkollat t'i shkurtojnë orët e mësimi për ta shmangur pikën e të nxehtëtë gjatë ditës. Metroja e Madridit ka shtuar trenat për t'i parandaluar pritjet e gjata në platformë, ndërkohë që pishinat publike pritet të hapen një muaj më herët se normalisht. Situata e njëjtë raportohet edhe në Portugali, ku termometri në disa zona të enjten arriti në 36 gradë.



PARAQITET DRAFT-RAPORTI PËR PUNËN E KUVENDIT GJATË VITIT 2022

IKD-ja: Kuvendi u injorua nga qeveria, deputetët e pushtetit i bojkotuan seancat

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) e ka vlerësuar të dobët punën e Kuvendit të Kosovës gjatë vitit 2022. Në paraqitjen e raportit të punës për Kuvendin nga ky institut, i pranishëm ka qenë edhe kryeparlamentari Glauk Konjufca. Në të është shkruar dhe thënë se legjislativi është injoruar nga qeveria. IKD-ja ka vlerësuar se deputetët e pushtetit e kanë bojkotuar punën e Kuvendit, ndërsa kryetari i Kuvendit ka thënë se deputetët e kanë obligim ligjor të marrin pjesë në seanca

EPOKA
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 28 PRILL (ER) - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) e ka vlerësuar të dobët punën e Kuvendit të Kosovës gjatë vitit 2022. Ky vlerësim është bërë në tryezën "Kuvendi i privilegjeve", në të cilën ky institut ka paraqitur raportin e titulluar: "DOBËT: Raport i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2022", i cili, sipas tij, pasqyron saktë gjendjen në Kuvendin e Kosovës.

IKD-ja ka thënë se Kuvendi e ka nisur punën pa miratuar programin e punës për vitin 2022, edhe pse një program i tillë parashihet me Rregulloren e Kuvendit të Kosovës, gjithashtu pa miratuar edhe programin e punës të sesionit vjeshtor në seancë plenare.

Sipas këtij Instituti, viti 2022 e ka karakterizuar Kuvendin me numër të madh të pikave të rendit të ditës nga seancat e mbetura nga viti 2021. "Seancat e rregullta të Kuvendit janë karakterizuar me vazhdimësi të shumta të seancave, që përbëjnë 53 për qind të totalit të seancave të rregullta. Kontrolli parlamentar lidhur me punën e qeverisë dhe mbikëqyrjes së institucioneve të pavarura pothuajse ka qenë inekzistent. Në shtë paku 18 raste Kuvendi ka dështuar t'i miratojë raportet vjetore të institucioneve kushtetuese dhe agjencive të pavarura. Po ashtu, ka dështuar në 18 raste t'i zgjedhë organet kolegjiale dhe individuale, duke bërë pengesë në funksionimin e tyre", është thënë në raportin e IKD-së nga monitorimi i punës së

Kuvendit për vitin 2022.

Sa i përket llogaridhënies së qeverisë përballë Kuvendit, IKD-ja ka gjetur se Kuvendi është injoruar nga qeveria, përderisa kryetari i Kuvendit nuk ka marrë masa ndaj qeverisë ashtu siç kërkohet me rregullore. "Edhe kjo legjislaturë është karakterizuar nga gjuha joparlamentare, polarizimi i skajshëm ndërmjet deputetëve dhe grupeve parlamentare dhe, po ashtu, ndërmjet deputetëve dhe kabinetit qeveritar", ka thënë Naim Jakaj, i cili e ka paraqitur raportin e IKD-së.

Në raport është thënë se gjatë vitit të kaluar 9 për qind e deputetëve janë përballur me ligjin.

Më tutje është theksuar se transparencja dhe llogaridhënia e Kuvendit mbeten sfida. "Mbledhjet e komisioneve parlamentare vazhdojnë të mos transmetohen nga Kuvendi, ndërsa jashtë funksionit mbetet votimi elektronik në seancat plenare, duke pamundësuar informimin e qytetarëve për votat



e tyre", është thënë në raportin e IKD-së.

Në lidhje me aktivitetin legjislativ, puna e Kuvendit është përcjellë me joefikasitet, sipas IKD-së. "Në secilën seancë plenare projektligjet janë bartur nga një seancë në tjetrën për shkak të mungesës së kuorumit nga ana e shumicës parlamentare dhe mospjesëmarrjes së opozitës në procesin e votimit. Në fund të vitit 2022 Kuvendi nuk i ka shqyrtuar në parim nëntë projektligje dhe në lexim të dytë dy projektligje. Përkundër faktit që i ka shqyrtuar,

Kuvendi nuk ka arritur të vendosë për tre projektligje në lexim të parë dhe për një projektligj në lexim të dytë. Këto projektligje janë bartur për shqyrtim dhe votim në sesionin pranveror të vitit 2023", është thënë në këtë raport. Sipas raportit të IKD-së, Kuvendi nuk e ka votuar asnjë projektligj të sponsorizuar nga ana e grupeve parlamentare opozitare (4 prej tyre), në ndërkohë ka votuar për dy projektligje të sponsorizuara nga grupi parlamentar i shumicës parlamentare. Jakaj ka thënë se

Kuvendi ka rritur përdorimin e praktikës së shmangies së afateve të parapara me Rregulloren e Kuvendit në lidhje me shqyrtimin e projektligjeve të rëndësishme. "11 për qind e projektligjeve janë miratuar në procedurë të përsheptuar. Në shumicën e rasteve përsheptimi është propozuar nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje", ka thënë Jakaj nga IKD-ja.

Ndërsa drejtori ekzekutiv i IKD-së, Ehat Miftaraj, ka thënë se Kuvendi është duke u bojkotuar nga deputetët e pushtetit. Ai ka thënë se edhe mungesa e pajisjeve është mungesë e transparencës, pasi qytetarët nuk e dinë se kush qysh ka votuar në seancë të Kuvendit. "Është sukses miratimi i Rregullores së Kuvendit, mirëpo ne shohim se kjo rregullore ka probleme. Kryetari i përmendi me shumë të drejtë privilegjet, përgjegjësitë, të drejtat e deputetit. Në këtë rregullore keni dështuar t'i përcaktoni sanksionet kur deputeti mungon në seancën e Kuvendit", ka thënë ai. Në paraqitjen e këtij raporti kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e partive parlamentare.

Konjufca: Prania e deputetit në seancë është detyrim ligjor

Në tryezën "Kuvendi i privilegjeve", e cila është organizuar nga KDI-ja, është publikuar edhe raporti me titull "DOBËT: Raport i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2022", në të cilën ka marrë pjesë edhe kryeparlamentari Glauk Konjufca. Në këtë konferencë ai

ka folur për mungesat e shpeshta të deputetëve në seanca. Sipas tij, prania e deputetit në seancë është detyrim ligjor, jo zgjedhje. "Shfaqja e deputetit në seancë është detyrim dhe nuk është zgjedhje. Nëse ndërjegjia e tij thotë 'nuk dua të vij në seancë', Kjo është antiligjore. Nëse ne

funksionojmë sipas ligjit si deputetë dhe nëse në ligj shkruan se ardhja në seancë është detyrim, atëherë a mund të më tregoni se çfarë është kjo? Ardhja në Kuvend është obligim i fuqishëm, në të kundërtën duhet ta informosh kryetarin pse nuk ke ardhur në seancë", ka thënë Konjufca.


Ish-ministrja Dhurata Hoxha lirohet nga akuza për korrupsion

PRISHTINË, 28 PRILL - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur aktgjykim lirues ndaj ish-ministres së Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, dy ish-sekretarëve të ministrisë, Demush Shasha dhe Kushtrim Cukaj, si dhe Fitim Mustafës e Nuh Osmanit, lidhur me akuzën për korrupsion. Aktgjykimi është shpallur të premten nga kryetari i trupit gjyqës,

Arben Hoti. Sipas gjykatësit Hoti, nga provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor nuk janë provuar faktet konkrete që përbëjnë elemente të kryerjes së veprës penale. Në seancën e 7 prillit 2023, të akuzuarit Hoxha, Shasha, Cukaj, Mustafa dhe Osmani ishin mbrojtur në heshtje nga akuzat për korrupsion. Të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm në seancën e

shqyrtimit fillestar, të mbajtur më 1 shtator 2021. Sipas aktakuzës së ngritur më 7 korrik 2021 nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, Dhurata Hoxha, Kushtrim Cukaj dhe Fitim Mustafa akuzoheshin se në vazhdimësi kanë kryer veprën penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar" nga neni 414, paragrafi 2, lidhur me nenin 77, paragrafi 1 i KPRK-së.





BASHKIMI EVROPIAN (BE) KONFIRMON AGJENDËN E TAKIMIT TË 2 MAJIT NË MES TË KRYEMINISTRIT TË KOSOVËS ALBIN KURTI DHE PRESIDENTIT TË SERBISË, ALEKSANDËR VUÇIQ

Asociacioni dhe Deklarata për të pagjeturit, në agjendën e takimit të 2 majit

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të diskutojnë më 2 maj në Bruksel për deklaratën e të pagjeturit dhe për draftin e parë të statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka bërë me dije se pas trajtimit të këtyre dy temave, do të shihet se a mund të diskutohet edhe për çështje të tjera në interes të dy vendeve. Çështja e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është hapur si temë edhe të enjten në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në të cilin i është bërë thirrje Kosovës që sa ma shpejt të themelojë këtë asociacion

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 28 PRILL - Tashmë edhe zyrtarisht është konfirmuar se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të diskutohet në takimin e 2 majit në Bruksel. Zëdhënësi i Bashkimit Evropian (BE), Peter Stano, ka bërë me dije se në takimin e ri të liderëve të Kosovës dhe të Serbisë, në rend dite do të jetë miratimi i Deklaratës për të pagjeturit dhe do të paraqitet drafti i parë i statutit për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, do të takohet me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, më 2 maj në Bruksel, nën ndërmjetësimin e zyrtarëve evropianë. Stano nuk ka dashur t'i komentojë kritikën e bëra nga

krerët shtetërorë serbë për zgjedhjet lokale që janë mbajtur më 23 prill në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe. Ai, po ashtu, nuk i ka komentuar ankesat e paraqitura nga Beogradi lidhur me nisjen e procesit të anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës. "Ne kemi diskutuar për këtë çështje gjerësisht para dy ditësh. Mund të përsëris se ne nuk i komentojmë deklaratat e palëve, por presim që ata të përqendrohen në zbatimin e obligimeve që kanë para tyre. Presim që të martën ta kemi vazhdimin e dialogut, që është platforma e vetme për diskutim", ka thënë Stano.

Si Kurti, ashtu edhe Vuçiq, kanë konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në takimin e 2 majit. "Takimi do të përqendrohet në zbatimin e marrëveshjes drejt normalizimit të

raporteve. Pikë e parë e agjendës do të jetë miratimi i Deklaratës për të pagjeturit. Pika e dytë do të jetë paraqitja e draftit të parë të statutit për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Pas këtyre dy temave do të shihet se sa mund të diskutohet edhe për çështje të tjera", ka thënë Stano. I pyetur se si do të shkojë përpara procesi nëse nuk do të ketë përparim për themelimin e Asociacionit gjatë takimit të 2 majit, Stano përsëriti se BE-ja pret që palët t'i zbatojnë obligimet që kanë marrë. "Në përgjithësi ne nuk spekulojmë rreth asaj se çfarë do të ndodhë nëse diçka nuk ndodh. Ne presim që palët të jenë të përkushtuara për t'i zbatuar obligimet. E formimi i asociacionit është një obligim i qartë. Ne presim të lëvizim përpara dhe ne si lehtësues presim që të zbatohen obligimet që palët kanë marrë përsipër", ka thënë Stano.

Kosova dhe Serbia e akuzojnë njëra-tjetrën për bllokim të dialogut

Gjatë diskutimeve për raportin e ri gjashtëmuor për Kosovën në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ministrat e Jashtëm të Kosovës dhe të Serbisë të enjten e kanë akuzuar njëri-tjetrin për bllokimin e dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Në seancën që është mbajtur në Nju-Jork të ShBA-së dhe është kryesuar nga Rusia, nga anëtarët e

Këshillit të Sigurimit është bërë thirrje të arrihet marrëveshje në Bruksel dhe që të dyja palët të përmbahen nga nxitja e tensioneve.

Ministrja e Jashtëm e Kosovës, Donika Gërvalla, ka thënë se Serbia është duke tentuar ta bllokojë integrimin e Ballkanit në Bashkimin Evropian dhe ta bllokojë përparimin në dialog. "Është e qartë që Serbia nuk do marrëveshje në dialog. Në të kundërtën, do ta pengojë çfarëdo marrëveshje sepse Serbia e 2023-s nuk do më të anëtarësohet në Bashkimin Evropian", ka thënë ajo. Ndërsa ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Daçiç, ka thënë se në fjalimin e Gërvallës është vërejtur se Kosova "nuk do në fakt një dialog. Ata duan vazhdimësinë e luftës, të konflikteve".

Gjatë fjalimit të saj, Gërvalla ia ka përmendur Daçiçit krimet ndaj popullatës shqiptare gjatë luftës së vitit 1999 dhe e ka krahasuar luftën në Kosovë me pushtimin aktual rus në Ukrainë, teksa ka thënë se "Serbia është kërcënimi më i madh për paqen në Ballkan".

Gjatë fjalimit të tij në Këshill të Sigurimit të OKB-së, Daçiç ka bërë thirrje që marrëveshjet e nënshkruara më parë në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi të implementohen. "Është e nevojshme të formohet Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe sa më shpejt që të jetë e mundur sepse ky është mekanizmi i vetëm i mundshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe sigurinë e komunitetit serb në

Kosovë", ka thënë Daçiç.

Gjatë mbledhjes së Këshillit të Sigurimit të OKB-së edhe përfaqësuesit e ShBA-së, Britanisë dhe Francës kanë kërkuar nga Kosova ta themelojë sa më shpejt Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.

Kujtojmë se takimi i 2 majit do të zhvillohet në kohën kur Kosova e ka akuzuar Serbinë se ka shkelur marrëveshjen drejt normalizimit të raporteve të arritur gjatë këtij muaji. Serbia ka votuar kundër anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës pavarësisht se me marrëveshjen drejt normalizimit është zotuar se nuk do ta pengojë Kosovën të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare. Po ashtu, zyrtarët në Beograd kanë paralajmëruar se do ta aplikojnë masën e reciprocitetit ndaj shteteve që nuk e respektojnë integritetin e saj territorial.

Sipas Kushtetutës serbe, Kosova konsiderohet pjesë e Serbisë. Ky paralajmërim i Serbisë për reciprocitet në Kosovë është cilësuar si shkelje e marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve të arritur nën ndërmjetësimin e BE-së dhe me përkrahjen e Shteteve të Bashkuara.

Në të kaluarën kryeministri Albin Kurti ka qenë kundër themelimit të çfarëdo asociacioni të komunave me shumicë serbe, por kjo temë tashmë do të trajtohet në takimin e 2 majit në Bruksel.

Kuvendi Komunal i Mitrovicës së Veriut kërkon hapjen e urës mbi Ibër, reagojnë Vuçiqi dhe Lista Serbe

MITROVICË, 28 PRILL - Asamblistët e komunës së Mitrovicës së Veriut, me propozimin e Aida Ferati - Dolit, kanë miratuar kërkesën për hapjen për qarkullim të urës kryesore mbi lumin Ibër.

Nga Qeveria e Kosovës nuk janë prononcuar për këtë vendim të autoriteteve lokale të Mitrovicës së Veriut. Mitrovica e Veriut është një nga katër komunat në veri të Kosovës që banohet me shumicë serbe.

Gjashtëmbëdhjetë asamblistët e kësaj komune janë zëvendësuar në dhjetorin e vitit të kaluar, pasi asamblistët paraprakë kanë dhënë dorëheqje, si pjesë e largimit kolektiv të serbëve nga institucionet e Kosovës në veri, në shenjë proteste me vendimin e Prishtinës për reregjistrimin e makinave me targa serbe në ato të Kosovës.

Në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Veriut ishte vetëm një asamblist serb, Dushan Millunoviq, i cili ka votuar kundër kërkesës për hapjen për qarkullim të urës mbi Ibër.

Pas luftës së fundit në Kosovë ura mbi lumin Ibër e ka ndarë Mitrovicën në dy pjesë, në atë jugore me shumicë shqiptare, dhe në pjesën veriore të banuar me shumicë serbe. Sot ato janë dy komuna të veçanta.

Ura mbi lumin Ibër apo "rivalizimi i urës" ka qenë temë e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e

raporteve, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Palët kishin rënë dakord që ura të ishte e hapur për qarkullim. Por, në praktikë kjo nuk ndodhi kurrë dhe vetëm njëra anë u hap për këmbësorët.

Ndërsa Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë, e ka kundërshtuar vendimin e asamblistëve të Mitrovicës së Veriut, duke e cilësuar "si të paligjshëm", shkruan "REL". Sipas kësaj partie, ky vendim "shkel marrëveshjet e Brukselit dhe kërcënon drejtpërdrejt paqen". "Duam të paralajmërojmë se hapja eventuale e urës padyshim që do të rezultojë me incidente në këtë zonë, gjë që duket se është edhe qëllimi i Prishtinës. Ura, ku kanë ndodhur më shumë se 1 000 sulme me motive etnike nga jugu në veri, është simbol i vuajtjes së popullit serb dhe synimi i Prishtinës është që t'i dëbojë serbët e mbetur nga i vetmi mjedis urban ku ata kanë mbijetuar në një numër më të madh", thuhet në reagimin e kësaj partie që ka mbështetjen e Beogradit.

Lista Serbe ka kërkuar nga KFOR-i, EULEX-i dhe përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare që "me urgjencë ta pengojnë zbatimin e këtij vendimi".

Ndërsa e ashtuquajtura Zyrë për Kosovën në Qeverinë e Serbisë ka thënë se kryeministri i Kosovës,



"Albin Kurti, sot pa dyshim ka treguar se dëshiron dhe ëndërron luftë, dhe do që i gjithë veriu i Kosovës të hyjë në konflikt". Duke reaguar pas vendimit për kërkesën për hapjen e urës mbi lumin Ibër, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dëshiron "t'i largojë serbët" nga Kosova, duke shtuar se udhëheqësi kosovar "dëshiron konflikte me çdo kusht". Vuçiqi nuk ka dhënë asnjë provë për këto pretendime.

Presidenti serb ka thënë se ura mbi lumin Ibër – që ndan Mitrovicën e Jugut dhe atë të Veriut – paraqet "një digë dhe mbrojtëse të interesave të popullit tonë në veri

të Kosovës dhe Metohisë". Serbia nuk e jeh pavarësinë e Kosovës dhe e konsideron pjesë të territorit të saj.

Vuçiqi ka thënë se me vendimin për hapjen e urës, shqiptarët "duan ta marrin" edhe Mitrovicën e Veriut. "Kjo është ideja e tyre e kamotshme, që për vite me radhë populli ynë e ka kundërshtuar", ka thënë ai. Vuçiqi ka thënë se Kurti do ta justifikojë këtë vendim duke thënë se "nuk do geto në Mitrovicë, por qytete të hapura" dhe se "për këtë do t'ia hedhë lehtë para përfaqësuesve perëndimorë". Sipas presidentit serb, shteti i tij "do të bëjë gjithçka" që të ruhet paqja. "Por, ne, po ashtu, po u

themi atyre para takimit në Bruksel më 2 maj dhe do të vazhdojmë edhe pas kësaj: as mos ëndërroni se do të keni sukses në qëllimet tuaja për të dëbuar apo shkatërruar serbët në çdo pjesë të Kosovës dhe Metohisë, sepse në atë rast ne do të dimë se çfarë duhet të bëjmë", ka thënë ai.

Në Bruksel, Kurti dhe Vuçiqi do të takohen më 2 maj në kuadër të dialogut që ndërmjetësohet nga blloku evropian. Zyrtarët evropianë kanë konfirmuar se në këtë takim pritet të miratohet Deklarata për të pagjeturit dhe do të paraqitet drafti i parë i statutit për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Kurti takohet me emisarin evropian dhe atë britanik, bisedojnë për zbatimin e marrëveshjes së Ohrit



PRISHTINË, 28 PRILL (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, është duke marrë pjesë në Forumin Vjetor Ekonomik në Delphi që organizohet nën përkujdesjen e presidentes së Greqisë, Katerina Sakellariopoulou. Në ditën e parë të këtij forumi, Kurti është takuar të premtën me emisarin special të BE-së, Miroslav Lajçak, me të cilin kanë biseduar për situatën

politike në vend dhe për takimin e radhës të nivelit të lartë që do të mbahet më 2 maj në Bruksel. Kurti ka thënë se marrëveshja themelore duhet të zbatohet plotësisht dhe shpejt, pa parakushte dhe pa vonesa. "Diskutuar për takimin e ardhshëm në Bruksel dhe për zgjedhjet e fundit lokale në katër komunat tona në veri me Miroslav Lajçakub në Forumin e

Delphit. Marrëveshja themelore duhet të zbatohet plotësisht dhe shpejt. Asnjë parakusht dhe pa vonesa", ka shkruar Kurti në "Twitter".

Po ashtu, Kurti është takuar me të dërguarin e posaçëm të Britanisë së Madhe, lord Stuart Peach, me të cilin ka diskutuar për marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet dy shteteve dhe për zhvillimet aktuale në Kosovë dhe

rajon. Kryeministri Kurti ka falënderuar lord Peach për mbështetjen e vazhdueshme të tij dhe të Britanisë që është konfirmuar edhe në rastin e pranimin të aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës në fillim të kësaj jave. Ata kanë diskutuar për mbajtjen dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve në katër komunat veriore të Kosovës, të cilat ishin të qeta, paqësore dhe

pa incidente. Në takim është biseduar edhe për raportet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për rëndësinë dhe urgjencën e zbatimit të plotë dhe të pakushtëzuar të marrëveshjes bazë dhe aneksit të zbatimit të dakorduar në Bruksel, respektivisht në Ohër, por edhe për pritjet nga takimi i radhës i nivelit të lartë politik që do të mbahet më 2 maj.

Kosova shënon Ditën e Tokës, Osmani kërkon angazhim të institucioneve

PRISHTINË, 28 PRILL - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me Zyrën e Presidencës së Republikës së Kosovës, Komunën e Prishtinës, UNDP-në, Ambasadën e Luksemburgut, Ambasadën Japoneze, USAID-in dhe shumë partnerë zhvillimorë, kanë shënuar të premtën Ditën e Tokës në Kosovë. Për të promovuar një mjedis pa mbeturina dhe potencialin e ekonomisë qarkore, në këtë ngjarje është paraqitur një strukturë e papërfunduar e lojërave, e cila është krijuar duke i ricikluar dhe i rindërtuar njësitë njëpërdorimëshe plastike. Me këtë rast presidentja Vjosa Osmani është shprehur se institucionet janë të përkushtuar të punojnë për problemet që lidhen me ndryshimet klimatike, mbeturinat, shpyllëzimin dhe ndotjen e ujit. Në këtë kontekst, ajo ka thënë se ta mbrosh tokën do të thotë ta mbrosh shëndetin, jetën dhe mirëqenien e njerëzve. "Ka një kohë që kemi filluar aktivitetet për tokën. Në disa hulumtime që janë bërë, të sfidave më të mëdha me të cilat jemi duke u përballur, ka rezultuar që problemet lidhen me

ndryshimet klimatike, mbeturinat, shpyllëzimin dhe ndotjen e ujit, e prekin edhe vendin tonë. Një gjë duhet ta kemi të qartë në trajtimin e këtyre çështjeve, vetë nuk mund t'ia dalim. Duhet të bashkëpunojmë. A kemi vullnet për të punuar në këtë drejtim? Konfirmoj se po. A kemi resurse? Konsideroj se na duhet bashkëpunim. Nuk ka asnjë alternativë tjetër. Ta mbrosh tokën dhe mjedisin do të thotë, të mbrosh shëndetin, jetën dhe mirëqenien", ka thënë ajo, raporton "EO". Ndërsa ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka thënë se falë partnerëve është arritur të ketë zhvillime në përmirësimin e mjedisit ku jetojmë. Aliu ka theksuar se Kosova nuk ka qasje në fondet e Kombeve të Bashkuar për fatkeqësitë natyrore sikurse vendet e tjera. Sipas tij, Kosova është duke lobuar që të ketë qasje në këto fonde të tjera. "Zhvillimet e pasluftës në Kosovë kanë qenë të shpejta. Sot po orientojmi drejt një qëndrueshmërie të duhur. Ne duhet t'i falënderojmë partnerët tanë që na kanë ndihmuar shumë në draftimin e



ligjeve që kanë të bëjnë me mjedisin. E tëra është e pamjaftueshme nëse nuk bashkëpunojmë me të gjithë qytetarët. Vendi ynë, pavarësisht

që po arrin t'i bëjë këto politika për mbrojtje të mjedisit, nuk ka qasje në fondet e Kombeve të Bashkuar. Jemi duke lobuar që të kemi qasje. Kemi vërshime e

shumë probleme të tjera. Vendet e tjera marrin. Fatkeqësisht, ne vetë duhet t'i mbulojmë shpenzimet me partnerët tanë", ka thënë Aliu.

ATRC-ja kërkon nga MSh-ja hartimin e listës së sëmundjeve profesionale

PRISHTINË, 28 PRILL (ER) - Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) ka kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë (MSh) t'i avancojë politikën e shëndetit në punë dhe garantimin e mbrojtjes së shëndetit të punëtorëve. Kërkesa e kësaj qendre vjen me rastin e Ditës Botërore të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. ATRC-ja ka thënë se këtë vit Kosova e shënon këtë ditë në një gjendje mjaft të rëndë të punësuarve, në kuptim të realizimit të të drejtave nga marrëdhënia e tyre e punës. Shqetësues, sipas ATRC-së, mbetet fakti i numrit të madh të aksidenteve në vendet e punës, qofshin ato që përfundojnë me lëndime të rënda, apo ato me fatalitet. "Sipas të dhënave zyrtare nga Inspektorati i Punës, 15 të punësuar kanë humbur jetën në vendin e tyre të punës vetëm në vitin 2022. Fatkeqësisht, kjo çështje shihet vetëm si statistikë, statistikë jokorrekte, sepse është e evidente që kemi diskrepancë të thellë në mes të statistikave të institucioneve të ndryshme lidhur me numrin e aksidenteve në vendin e punës që përfundojnë me humbje jete. Përkundër premtimeve dhe paraqitjeve publike të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, që do t'i marrin me prioritet të drejtat e punëtorëve, fatkeqësia e humbjeve të jetës të të punësuarve po rritet çdo vit",



është thënë në reagimin e ATRC-së. Sipas ATRC-së, paralelisht me situatën jo të mirë të sigurisë në punë, njëjtë qëndron edhe fusha e shëndetit në punë. Madje, sipas tyre, situata me shëndetin në punë vazhdon të mbetet e parregulluar juridikisht dhe e pazbatuar praktikisht. "Ligji nr. 04/L-125 për Shëndetësi thekson dhe trajton mjekësinë e punës vetëm sipërfaqësisht, ndërkohë që Ministria e Shëndetësisë nuk ka arritur ende të themelojë dhe funksionalizojë ndonjë institut të mjekësisë së punës i cili do të

merrej njëmendësisht me studime dhe hulumtime të sëmundjeve profesionale që lidhen me punën, por vetëm të tilla që më shumë konsiderohen si institucione të zakonshme shëndetësore që diagnostikojnë dhe ofrojnë shërbime shëndetësore. Madje Ministria e Shëndetësisë nuk ka arritur ende ta hartojë dhe fuqizojë listën e sëmundjeve profesionale, ndërkohë që këtë e kanë bërë vendet e rajonit dhe punëtorët gjithnjë e më shumë largohen në vende të tjera me kushte më të mira të punës. Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional

vërehet edhe në kuptim të regjistrimit dhe analizimit të të dhënave që lidhen me aksidentet në punë, apo edhe me sëmundjet profesionale dhe që lidhen me punën", është thënë në reagimin e ATRC-së, i cili është mbështetur nga 30 organizata joqeveritare dhe sindikata të ndryshme. Në reagim është thënë se ka një zbrastë të rregullimit të politikave në këtë fushë, të mosidentifikimit të sëmundjeve profesionale, si dhe mungesë të databazës për regjistrimin e rasteve të aksidenteve në punës. Andaj këto organizata dhe sindikata kanë

kërkuar nga MSh-ja që të iniciohet plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësinë duke i dhënë një vëmendje të veçantë shëndetit në punë.

Rrjedhimisht është kërkuar që me ligj të themelohen institutet e mjekësisë së punës, duke iu përcaktuar qartë detyrat e punës dhe mandati. Këto institute, sipas këtyre OJQ-ve dhe sindikatave, ndër të tjera, duhet të kenë për mandat themelor hulumtimin dhe studimin e sëmundjeve profesionale që lidhen me punën, si dhe të ofrojnë shërbime të mjekësisë së punës në nivel të Republikës së Kosovës dhe të mos marrin rol vetëm diagnostikues sikur të ishin qendra diagnostikuese.

Në fund, këto organizata në krye me ATRC-në kanë thënë se është shumë e nevojshme të artikulohet dhe fuqizohet lista e sëmundjeve profesionale si dhe të krijohet një bazë e të dhënave, ku do të regjistroheshin të gjitha rastet e sëmundjeve profesionale në Republikën e Kosovës. "Përdërisa nuk ekzistojnë hapa konkretë për përmirësimin e situatës në fushën e shëndetit në vendin e punës dhe në aspektin e mirëqenies, punëtorët janë ata të cilët po pësojnë më së shumti, rrjedhimisht po largohen nga vendi në kërkim të kushteve më të mira të punës", është thënë në reagimin e ATRC-së.

Familjet me asistencë sociale do t'i pranojnë paratë në llogaritë bankare

PRISHTINË, 28 PRILL (ER) - Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) ka bërë me dije se familjet me asistencë sociale nga ky muaj do ta pranojnë asistencën në llogari bankare. "Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) njofton familjet përfituese të Asistencës Sociale se që nga ky muaj (prill 2023) do të pranojnë mjetet e asistencës në llogaritë private bankare,

bazuar në konfirmimet që kanë dorëzuar në Qendrat për Punë Sociale", është thënë në njoftimin e MFPT-së. Sipas njoftimit, përfituesit e asistencës sociale duhet të drejtohen te zyrat apo pikat e bankave komerciale, ku i kanë llogaritë e tyre, për t'i pranuar mjetet e asistencës. Deri më tani asistencë sociale është shpërndarë përmes zyrave postare.

"Në rast se ndonjë familje nuk pranon mjetet financiare për asistencë sociale për muajin prill 2023, atëherë duhet të paraqiten sa më parë në Qendrën për Punë Sociale në komunën e tyre dhe të njoftojnë zyrtarët e ndihmave sociale", është thënë në njoftimin e MFPT-së. Përfituesit e asistencës sociale me status të azilantit do të vazhdojnë ta pranojnë asistencën në zyrat postare.



Ndahen 17 milionë euro për 450 organizata ballkanike, përfitojnë edhe ato nga Kosova



PRISHTINË, 28 PRILL - Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim ka mbajtur ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjeve të granteve me organizatat përfituese të raundit të parë për aplikime për grante për iniciativa lokale, grante për media dhe grante kreative, në kuadër të projektit rajonal SMART Balkans. Përmes skemës së granteve, projekteve rajonale, konferencave dhe vizitave studimore, projekti synon të kontribuojë në rritjen e ndikimit të shoqërisë civile në fushat e sigurisë, stabilitetit dhe qeverisjes së mirë dhe ta nxisë bashkëpunimin rajonal. SMART Balkans përgjatë një periudhe katërvjeçare (2022-2025) do të mbështesë me grante 450 organizata të shoqërisë civile,


medie dhe grupe joformale në rajonin e Ballkanit Perëndimor me vlerë mbi 17 milionë euro. Gjergji Vurmo nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim ka shprehur kënaqësi me numrin e organizatave që kanë aplikuar, duke shtuar se ka qenë një periudhë gjashtëmujore intensive e përzgjedhjes së përfituesve. Nga Kosova, Vurmon ka sqaruar se kanë përfutur disa organizata që do ta zbatojnë projektin në tre vitet e ardhshme. Ai e ka falënderuar Ambasadën e Norvegjisë për kontributin e vazhdueshëm në Kosovë dhe në Shqipëri. Ndërsa ambasadori i Norvegjisë në Republikën e Kosovës, Jens Erik Grondahl, ka thënë se qeveria norvegjeze do ta vazhdojë bashkëpunimin me organizatat e

shoqërisë civile. Ai ka thënë se në Kosovë, në bazë të raportimeve, mediet janë në presion, duke shtuar se këto të fundit e kanë mbështetjen e tij në mënyrë që ta luajnë rolin për informim e të funksionojnë të lira. Për ndarjen e granteve për medie përfituese janë organizata "Kosova Glocal" dhe "Goradzevac Media Gropu". Në grantet e nismave lokale kanë përfutur organizata "Community Building Mitrovica", "Green Art Center Prishtina", "Proaktiv", "Sundimi i Demokracisë në Kosovë", "Advocacy Center for Democratic Culture", "The Balkan Forum" si dhe "Udruzennje mladih-Mlada aktivna Graçanica". Sa i përket granteve kreative organizatat përfituese janë "Mural Fest Kosova" dhe "Anibar".

Togeri i FSK-së, Ylli Dalladaku, nderohet me çmimin "International Honor Graduate" në ShBA

Prishtinë, 28 prill (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka bërë me dije se togeri Ylli Dalladaku ka përfunduar me rezultate të shkëlqyeshme Kursin Bazik për Oficer të Këmbësorisë (IBOLC) në Gjeorgji të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), duke u shpërblyer me çmimin "International Honor Graduate", gjithashtu me rezultatet arritura është bërë pjesë e listës së më të mirëve (Commandant's List). Mehaj në një postim në "Facebook" ka shkruar se togër Dalladaku ka treguar performancë të lartë, duke e paraqitur

denjësisht Forcën e Sigurisë së Kosovës. "Gjatë 19 javëve të këtij kursi Togër Dalladaku tregoi performancë të lartë, duke e prezantuar denjësisht Forcën e Sigurisë së Kosovës, në mesin e 170 pjesëmarrësve sa ishin në kurs, oficerë amerikanë dhe oficerë nga shtete të ndryshme të botës. Togër Dalladaku përfundoi studimet ushtarake në Akademinë West Point në ShBA dhe nga viti 2020 u kthye në Kosovë për të shërbyer si oficer i Forcës së Sigurisë së Kosovës. Sukseset e mëtutjeshme. Ushtarakët tanë, krenaria jonë!", ka shkruar Mehaj.



Certifikohen rezultatet zgjedhore për kryetarë të katër komunave në veri

PRISHTINË, 28 PRILL - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar të premtën rezultatet e zgjedhjeve për kryetarë të katër komunave veriore. Rezultatet janë certifikuar pasi nuk ka pasur asnjë ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP). Në bazë të këtij rezultati, në komunën e

Mitrovicës së Veriut dhe në atë të Leposaviqit kanë fituar kandidatët e Lëvizjes Vetëvendosje, konkretisht Erden Atiq dhe Lulzim Hetemi. Kurse në komunën e Zveçanit dhe në atë të Zubin-Potokut kanë fituar kandidatët e Partisë Demokratike të Kosovës, respektivisht Ilir Peci dhe Izmir

Zeqiri. Zgjedhjet në veri të dielën e kaluar janë mbajtur në mënyrë të qetë. Ndonëse në aspektin ligjor ato ishin në rregull, kontestimi i tyre po bëhet në aspektin politik për shkak të pjesëmarrjes shumë të ulët të qytetarëve dhe bojkotimit nga komuniteti serb.



Thesari i shtetit bllokoi mbi 6 000 lëndë përmbarimore për pagesa

PRISHTINË, 28 PRILL - Ministria e Financave ka bllokuar mbi 6 000 lëndë përmbarimore për pagesa që janë në shqyrtim në Thesarin e shtetit. Një gjë e tillë është duke u konsideruar shqetësuese dhe dëmtuese ndaj bizneseve të cilat kanë lëndë të zgjidhura nëpër gjykata. Ministria e Financave, e drejtuar nga Hekuran Murati, ka bërë me dije se ka probleme me sigurim të fondeve për t'i kryer pagesat ndaj kompanive për të cilat shteti ka obligime. Thesari ka listuar gjashtë arsye pse po ndodh vonesa e shqyrtimit të këtyre mijëra lëndëve. "Të gjendur në situatë të tillë, Thesari e ka të pamundur ekzekutimin e vendimeve në afat të shkurtër kohor për arsyet të cilat do t'i listojmë si në vijim: 1. Lëndët dorëzohen të pakompletuara apo edhe me gabime nga ana e gjykatës apo përmbaruesve privatë, të cilat pamundësojnë realizimin e pagesave e që, për rrjedhojë, marrin kohë për procedim për

ekzekutim. 2. Kryerja e verifikimeve shtesë me qëllim të shmangies së pagesave të dyfishta, duke pritur edhe konfirmime nga ana e organizatave buxhetore në cilësi të palës debitorë. 3. Mungesa e ndarjeve buxhetore në dispozicion të debitorëve, pra lëndët nuk arrijnë të ekzekutohen për arsye tërësisht objektive që nuk varen nga thesari, edhe pse tentohet disa herë realizimi i pagesës nuk arrihet në mungesë të buxhetit në dispozicion të organizatës buxhetore - debitorit. 4. Mungesa e buxhetimit apo alokimit të fondeve sipas Ligjit nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023. 5. Bartja e lëndëve nga viti paraprak të cilat nuk kanë arritur të ekzekutohen në fund të vitit të kaluar për arsye të mungesës buxhetore në dispozicion të organizatave buxhetore - debitorëve, lëndë të cilat janë bartur në këtë vit fiskal

për ekzekutim. 6. Ekzekutimi i vendimeve në përputhje me shpenzimin e krijuar sipas kategorisë ekonomike", është thënë në përgjigjen e Thesarit. Për zvarritjen ose bllokadën e këtyre vendimeve gjyqësore ka raportuar ditë më parë "Kosovapress". Kryetari i Odës së Përmbaruesve Privatë në Kosovë, Arben Gashi, ka thënë se mosekzekutimi i urdhrat të përmbaruesit përbën shkelje ligjore nga Ministria e Financave, në këtë rast nga Thesari. Sipas Gashit, ligjërisht Thesari do të duhej t'i ekzekutojë mjetet financiare brenda 24 orëve. Gashi ka theksuar se vonesa e ekzekutimit të lëndëve në thesar janë shqetësuese dhe, sipas tij, kreditorët ligjërisht kanë të drejtë të kërkojnë kamatën prej 8-përqindësh për këto vonesa. Ndërsa zyrtarë të Thesarit kanë pranuar për "Kosovapress" se 6 mijë lëndë përmbarimore janë në sirtarë të këtij institucioni. "Për informimin tuaj, këtë vit



Thesari ka të evidentuara në procedurë të ekzekutimit mbi 6 mijë lëndë deri tani, lëndë këto të pranuar nga autoritetet përmbaruese si gjykata dhe përmbaruesit privatë (të cilat ndodh që dorëzohen të pakompletuara apo edhe me gabime të cilat pamundësojnë realizimin e pagesave e që për rrjedhojë marrin kohë për procedim për ekzekutim", është thënë në përgjigjen e Thesarit. Disa prej biznesmenëve kanë theksuar se derisa vetë këto

institucione kërkojnë nga kompanitë private t'i përmbaruesit obligimet ndaj ATK-së në afatet kohore, Ministria e Financave shkel ligjet në fuqi për ekzekutimin e lëndëve përmbarimore. Për këto ankesa, nga kjo ministri, kanë thënë se për këtë çështje është përgjegjës ATK-ja. Përveç kësaj, sfidë tjetër për kreditorët mbetet vonimi i shqyrtimit të mijëra lëndëve përmbarimore në gjykata, përkatësisht në Gjykatën Komerciale.

Mielli lirohet, buka jo

PRISHTINË, 28 PRILL - Ka një muaj që Feride Hyseni ka thënë se e gatuan vetë bukën për familjen pesëanëtarëshe që jeton në Fushë-Kosovë. Kjo është më e leverdishme për të, pasi çmimi i miellit është liruar. "Nga 16 euro sa i kam blerë para disa muajsh, tash 25 kilogramë miell i blej 13.50 euro. Buka në qytetin e Fushë-Kosovës kushton nga 50 deri në 60 centë. Ky çmim është i shtrenjtë, pasi ne i konsumojmë katër bukë në ditë, që kushtojnë 2 euro. Për 60 euro në muaj unë kam llogari të gatuaj, pasi nuk punoj", ka thënë Feridja për "Radion Evropa e Lirë". Ndërsa Agim Maloku, i cili punon në një kompani private në Prishtinë dhe paguhet 250 euro në muaj, thotë se familja e tij treanëtarëshe e blen bukën. "Çmimi i bukës duhet të ndryshojë, sepse duhet të shkojë në proporcion me miellin", thotë ai. Çmimi i një buke prej 500 gramësh në shumicën e qyteteve të Kosovës ka mbetur 50 centë prej muajit korrik të vitit të kaluar - kur është rritur nga 40 centë sa ka qenë deri atëherë - ndërkohë që çmimi i miellit është në rënie.

Kosova është përballur me rritje çmimesh të produkteve dhe shërbimeve që nga fundi i vitit 2021, kryesisht për shkak të çrregullimeve në furnizime që ka shkaktuar pandemia e koronavirusit. Hov, pastaj, u ka dhënë edhe pushtimi rus i Ukrainës, i cili ka nisur në fund të shkurtit 2022. Si Rusia ashtu edhe Ukraina janë ndër eksportueset më të mëdha të drithërave në botë dhe lufta mes tyre ka shkaktuar çrregullime në tregje. Në anën tjetër, pronari i furrës së bukës "Dea" në Prizren, Elvis Kalanderi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se çmimi i bukës ka mbetur i pandryshuar, sepse nuk ka blerë ende miell me çmim më të lirë. Ai ka thënë se edhe pasi të blejë sasi të reja mielli, zbritja e çmimit të bukës do të jetë e vështirë për shkak të, siç thotë, shtrenjtimit të faturave të energjisë elektrike dhe rritjes së pagave të punëtorëve. Aktualisht në furrën e tij punojnë shtatë punëtorë dhe paga e tyre sillet nga 500 deri në 1 000 euro. "Nuk e di se si do t'i ulim çmimet, si të paguhen punëtorët, faturat e rrymës... Kjo e vështirëson



buxhetin e biznesit", ka thënë Kalanderi. "Radio Evropa e Lirë" ka vizituar edhe disa furra të bukës në Prishtinë, por pronarët e tyre nuk kanë pranuar të flasin për arsyet e mosrritjes të çmimit të bukës dhe produkteve të tjera nga mielli. Nga Shoqata e Mullisëve të Kosovës kanë konfirmuar për "Rel"-in se çmimi i miellit është në rënie. Kryetari i saj, Bashkim Zejnullahu, njëherësh pronar i fabrikës së miellit "Thesari", ka thënë se nga 52 euro sa kanë kushtuar 100 kilogramë miell në fillim të vitit, ata aktualisht blihen me 40 deri në 44 euro. "Tregjet botërore kanë ndikuar në uljen e çmimit, hapja e tregut ukrainas e ka bërë të vetën. Pasi është liruar çmimi i grurit, jemi detyruar ta lirojmë miellin", ka thënë Zejnullahu. Sapo kur lirohet lënda e parë, bizneset duhet të reflektojnë edhe

te produkti final, thotë profesori i lëndës së Makroekonomisë dhe Mjedisit në Biznes në Universitetin e Prishtinës, Nagip Skenderi. "Në periudhën e fundit kemi një rënie të çmimeve të vajrave, derivateve të naftës, grurit, miellit... por nga aspekti i tregut nuk kemi ndonjë luhatje në këtë kontekst. Ndoshta, në rast të caktuara, kemi edhe ngritje të çmimit, pasi ato (bizneset) po e marrin si pretekst ngritjen e çmimit të energjisë elektrike dhe atë përqindje të rritjes po e reflektojnë të çmimi i bukës", ka thënë Skenderi për "Radion Evropa e Lirë". Nga fillimi i këtij muaji në Kosovë kanë hyrë në fuqi fatura të reja të energjisë elektrike - për 15 përqind më të shtrenjta. Skenderi, megjithatë, thotë se nuk është e drejtë që çmimi i bukës të mos bjerë dhe kërkon nga autoritetet përgjegjëse ta inspektojnë tregun dhe të marrin masa. "Kemi një inflacion abuzues nga furrat dhe prodhuesit e tjerë të bukës. E gjithë kjo ndodh para syve të Autoritetit të Konkurrencës dhe Inspektoratit të Tregut", ka thënë ai.

"Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për këtë çështje, por nuk ka marrë përgjigje. Nga Autoriteti i Konkurrencës kanë thënë se kanë bërë monitorime në disa rajone të Kosovës, më ç'rast kanë konstatuar se ka çmime të ndryshme të bukës, varësisht prej furrës, marketeve në lagje dhe qendrave tregtare. Për mundësinë e keqpërdorimit të çmimeve ose ndonjë marrëveshjeje eventuale në mes të prodhuesve të bukës, ky autoritet ka thënë për "REL"-in se pritet ta inspektojë tregun dhe, nëse gjen parregullsi, "do të reagojë sipas detyrës zyrtare". Hollësi të tjera nuk ka dhënë. Kosova nuk arrin t'i plotësojë nevojat e popullatës me miell dhe grurë, andaj edhe importon sasi që kapin vlerën e miliona eurove, kryesisht nga vendet fqinje. Vitin e kaluar Kosova e ka përmbyllur me normë mesatare të inflacionit gati 12 përqind. Nga Banka Qendrore e Kosovës kanë paralajmëruar se rënia e inflacionit do të vërehet në pjesën e dytë të vitit.

Protestojnë punëtorët e KEK-ut, kërkojnë rritje të pagave

PRISHTINË, 28 PRILL - Sindikata e Re e Korporatës Energjetike e Kosovës (KEK) ka protestuar me kërkeshën rritje të pagave. "Hajnat jashtë, hajnat jashtë", ishin disa nga thirrjet e punëtorëve të KEK-ut. Kryetari i Sindikatës së Re të KEK-ut, Nexhat Llumnica, ka thënë se janë mashtruar nga menaxhmenti për rritje të pagave. Llumnica ka treguar se nuk do të heqin dorë nga kërkesat e tyre, duke paralajmëruar edhe grevë nëse nuk marrin përgjigje. "Ne shprehim pakënaqësi dhe

prodhojmë energji elektrike. E di që ndoshta nuk jeni të kënaqur me ne, por disa individë, sidomos bordi i KEK-ut, na ka gënjyer që në fund të prillit të bëhet diçka. Në fund na thanë se në fund të majit do të kemi një shpërblim por, jo. Ne po kërkojmë rritje pagash, jo shpërblim", ka thënë Llumnica, duke shtuar se: "Marre me rrejt. Punëtorët e KEK-ut nuk janë të veshur me ngjyra partiake, por me uniformën e KEK-ut. Deri në orën 16:00 nuk shikojmë parti politike, prandaj kërkojmë nga qeveria t'i rrisë pagat dhe

shujtat ushqimore. Ne me ju do të jemi të vendosur dhe nuk do të lëshojmë pe, dhe nuk do t'i plotësojmë dëshirat. Ne po dyshojmë se disa individë po na imponojnë grevën, e sot po i paralajmërojmë se nuk do të lëshojmë pe", ka thënë Llumnica. Ndërsa Ali Gashi nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës i ka quajtur heronj punëtorët e KEK-ut. Ai ka thënë se falë tyre Kosova po ndriçohet, raporton "EO". "Është për të ardhur keq që për neglizhencë të qeverisë t'i qesin



në rrugë punëtorët që na bëjnë dritë. Ju vërtet jeni heronj dhe dhatë gjithçka që sot Kosova është e zhvilluar, që sot

ekonomia është e zhvilluar. Ndoshta dikujt i ka interesuar që të dështojë KEK-u", ka thënë Gashi.

ChatGpt ka një problem serioz me shpifjen



Krahas problemeve të ndryshme të privatësisë që po hasen në Itali dhe jo vetëm, skenaritet "Terminator", përhapjes së lajmeve të rreme dhe detyrave shkollore të studentëve, ChatGptka filluar që të shpifë mbi disa persona. Nëse nuk zgjidhet sa më shpejt që të jetë e mundur, ky problem mund të përmbytë me ankesa

kompaninë mëmë të saj OpenAi. Deri më sot janë vetëm 2 rastet më flagrante. Por ato kanë prekur një zyrtar publik dhe një profesor të drejtësisë, figura që për shkak të roleve të tyre, kanë kërcënuar tashmë se mund të bëjnë paditë e para kundër OpenAi për shpifje përmes inteligjencës artificiale.

Kryebashkiaku akuzohet për korrupsion

Njerëzit e prekur janë Brajan Hud, kryebashkiak i Hepbërn Shajër, një komunë afër Melbërnit, Australi, dhe Xhonathan Tërlej, një profesor i jurisprudencës në Universitetin Xhorxh Uashington, Shtetet e Bashkuara. I pari mësoi nga disa votues se ishte cilësuar gabimisht nga ChatGpt si fajtor për një skandal korrupsioni, që përfshinte një degë të Bankës Rezervë të Australisë në fillim të viteve 2000.

Në këtë rast, gabimi i inteligjencës artificiale është se Hud ka punuar në fakt ka punuar për një degë të bankës australiane. Por ajo që nuk kuptoi ChatGpt, është se Hud ishte personi që raportoi tek autoritetet rryshfetet e dhëna ndaj zyrtarëve të huaj, për të

fituar tenderat për printimin e kartëmonedhave.

Avokatët e tij, të cilët kanë konfirmuar se ai nuk është akuzuar kurrë për ndonjë krim, i dërguan më 21 mars një letër OpenAi për ta korrigjuar gabimin, duke i lënë 28 ditë kohë para se ta paditin për shpifje. Por sipas raporteve të Reuters, nuk ka marrë ende asnjë përgjigje.

Profesori akuzohet për ngacmim seksual

Nga ana tjetër, i dyti e zbuloi shpifjen falë një kolegu të tij, i cili i kërkoi ChatGpt t'i siguronte një listë të studiuesve të së drejtës, që ishin shpallur fajtorë për ngacmim seksual. Dhe sistemi renditi në listë edhe emrin e Tërlej. Sipas AI, profesori dyshohet se ngacmoi verbalisht, dhe tentoi të

ngacmonte seksualisht një studente gjatë një ekskursioni shkollor nëAlaska, duke cituar si burim një artikull të gazetës "Washington Post" të vitit 2018. Por problemi është se nuk ka ekzistuar ndonjëherë një artikull i tillë, dhe Tërlej nuk ka qenë asnjëherë në Alaskë. Ndryshe nga Hud, Tërlej, i cili ka deklaruar se nuk ka ngacmuar seksualisht askënd në jetën e tij. Por duket se ai nuk ka ndërmarrë ende asnjë veprim kundër OpenAi.

Por mund ta bëjë këtë nëse gabimi nuk korrigjohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Për të justifikuar incidentin, Niko Feliks, zëdhënës i OpenAi, tha se "kur përdoruesit regjistrohen nëChatGpt, ne përpiqemi të jemi sa më transparentë për faktin se ai mund të gjenerojë përgjigje që nuk janë gjithmonë të sakta". / Wired – Bota.al

Ç'mund të na thotë shkencë për përvojën e dukurive paranormale

Nga Ben ALDERSON-DAY

Nëse keni pasur ndonjëherë ndjesinë e frikshme se në dhomën tuaj ka pasur një prani të diçkaje edhe kur keni qenë të sigurt se ishit vetëm, mund të hezitoni që ta pranoni. Ndoshta ishte një përvojë e thellë, të cilën je i lumtur ta ndash me të tjerët. Ose më shumë gjasa diçka midis të dyjave.

Në rast se nuk keni pasur një shpjegim që t'ju ndihmojë ta përpunoni atë përvojë, shumica e njerëzve e kanë të vështirë ta kuptojnë atë që u ndodhi. Por tani kërkimet po tregojnë se kjo përvojë e çuditshme është diçka që ne mund ta kuptojmë, duke përdorur modele shkencore të mendjes, trupit dhe marrëdhënien midis të dyjave.

Një nga studimet më të mëdha mbi këtë temë është kryer që në vitin 1894. Shoqata për Kërkime Psikike (SPR) publikoi Censusin mbi Halucinacionet, një anketë që përfshiu më shumë se 17.000 njerëz në Britaninë e Madhe, SHBA dhe Evropë.

Sondazhi synonte të kuptonte se sa e zakonshme ishte që njerëzit të kishin vizita në dukje të pamundura që parashikonin vdekjen e tyre. SPR arriti në përfundimin se përvoja të tilla ndodhën shumë shpesh për t'u cilësuar si shjesht rastësore (1 në çdo 43 persona që u anketuan).

Në vitin 1886, SPR (që kishte si klient edhe ish-kryeministrin britanik Uilliam Gledstoun dhe poetin Alfred Tenison) botoi librin "Fantazmat e gjalla". Ai përfshinte 701 raste të telepatisë, parandjenjave dhe fenomeneve të tjera të pazakonta.

Për shembull, Atë RH.Njuhem nga Devonport, tregoi historinë e një vizite në Zelandën e Re, ku një fantazmë që iu shfaq gjatë natës e paralajmëroi atë të mos shkonte në një udhëtim me varkë që do të organizohej mëngjesin e ditës tjetër. Më vonë ai mësoi se të gjithë në atë udhëtim ishin mbytur.

Në atë kohë, fantazmat u kritikuan si një pretendim që nuk kishte baza shkencore. Regjistrimi i dëshmimeve të tilla pritej me një lloj skepticizmi, por ai vuante nga njëanshmëria e përgjigjes (kush do të shqetësohej t'i përgjigjej një sondazhi të tillë, përveç atyre që kishin diçka për të thënë).

Por përvoja të tilla raportohen në mbarë botën, dhe shkencë bashkëkohore na ofron sot një ide për t'i kuptuar ato. Shumë prej dëshmimeve të mbledhura nga SPR tingëllojnë si hipnagogji:përvoja halucinative që ndodhin në kufijtë e gjumit. Po ashtu është sugjeruar se disa përvoja fetare të regjistruara në shekullin XIX-të, e kanë një bazë të hipnagogjia.

Shfaqja e qënieve të pazakonta, ka një lidhje veçanërisht të fortë me paralizën e gjumit, që përjetohet nga rreth 7 për qind e të rriturve të paktën një herë në jetën e tyre. Në paralizën e gjumit, muskujt tanë mbeten të ngrirë, tamam si në fazën e gjumi REM, por mendja jonë është aktive dhe zgjuar.

Studimet kanë sugjeruar se më shumë se 50 për qind e njerëzve me paralizën e gjumit,raportojnë se kanë përjetuar një ngjarje paranormale. Ndërsa ngjarje të tilla në vitet 1800 të dokumentuara nga SPR ishin shpesh qëllim-mira ose ngushëlluese, shembujt modernë të shkaktuar nga paraliza e gjumit



priren të përjetohej si keqdashëse. Shoqëritë në mbarë botën kanë historitë e tyre mbi fantazmat që shfaqen natën – nga "frati trupvogël me dorën e shpuar" në Portugali (Fradinjo da Mao Furada) që besohet se mund të depërtonte në ëndrrat e njerëzve, tek Ogun Oru i popullit Joruba në Nigeri, që besohet se është jetë produkt i viktimave të magjepsura.

Por pse një përvojë e tillë si paraliza e gjumit do të krijonte ndjesinë e një pranie paranormale në dhomë? Disa studiues janë fokusuar tek karakteristikat specifike të zgjimit në një situatë kaq të pazakontë. Shumica e njerëzve e shohin të frikshme paralizën e gjumit, edhe kur ajo është pa halucinacione.

Në vitin 2007, studiuesit e gjumit J.Allen Çejn dhe Tod Zhirar argumentuan se nëse ne zgjohemi të paralizuar dhe të pambrojtur, instinktet tona do të na bëjnë të ndihemi të kërcënuar dhe mendja jonë e plotëson boshllëkun. Nëse duket sikur jemi pre, atëherë duhet të ketë patjetër një grabitqar.

Një qasje tjetër është të analizojmë të përbashkëtat midis "vizitave" gjatë paralizës së gjumit dhe llojeve

të tjera të pranisë që perceptohet. Hulumtimet e 25 viteve të fundit kanë treguar se shfaqja e një qënieje të pazakontë që na kumton diçka nuk është vetëm një pjesë e rregullt e peizazhit hipnagogjik, por raportohet edhe tek personat që vuajnë nga sëmundja e Parkinsonit, psikozat apo përvojat afër vdekjes. Kjo sugjeron se ajo nuk ka gjasa të jetë një fenomen specifik i gjumit. Ne e dimë nga studimet e rasteve neurologjike dhe eksperimentet me stimulimin e trurit, se prani të tilla mund të provokohen nga shenjat trupore. Për shembull, në vitin 2006 neurologu Shahar Arzidhe kolegët e tij ishin në gjendje të krijojnë një "figurë hije" që u përjetua nga një grua, truri i së cilës po stimulohej elektrikisht në kryqëzimin e majtë temporoparietal (TPJ).

Figura dukej se pasqyronte pozicionin e trupit të gruas, ndërsa TPJ kombinon informacione rreth shqisave dhe trupave tanë. Një seri eksperimentesh në vitin 2014, treguan gjithashtu se prishja e pritshmërive shqisore të njerëzve, duket se shkakton një ndjenjë pranie te disa njerëz të shëndetshëm.

Mënyra se si funksionon procedura që përdorën studiuesit, është t'ju mashtrorë që të ndiheni sikur po prekni shpinën tuaj, duke sinkronizuar lëvizjet tuaja me një robot direkt pas jush. Njëkëtë mënyrë, truri ynë merr kuptim të sinkronizimit duke arritur në përfundimin se jemi ne, ata që po e prodhojmë atë ndjesi.

Më pas, kur ky sinkronizim ndërpritet, njerëzit mund të ndihen papritur sikur i pranishëm është edhe një person tjetër. Ndryshimi i pritshmërive shqisore të situatës, shkakton diçka të ngjashme me një halucinacion. E njëjta logjikë mund të përdoret për të shpjeguar një situatë si paraliza e gjumit.

Të gjitha informacionet tona të zakonshme për trupat dhe shqisat tona janë ndërprerë në atë kontekst, ndaj nuk është çudi që ne mund të ndihemi sikur ka dhe diçka "tjetër". Mund të ndihemi sikur është një tjetër prani, kur në fakt jemi vetëm ne.

Në studimin tim në vitin 2022, u përpoqa të gjurmoja ngjashmëritë tek dëshmitë klinike, praktikat spirituale dhe sportet e qëndrueshmërisë (që janë të njohura për prodhimin e një sërë fenomenesh halucinative, përfshirë ndjesinë e pranisë së dikujt tjetër).

Në të gjitha këto situata, ishin të ngjashme shumë aspekte të ndjenjës së një pranie. Për shembull, subjekti ndjeu se prania ishte pas shpinës së tij Prezencat e lidhura me gjumin u përshkruan nga të tre grupet, dhe po të tilla ishin edhe prania e nxitura nga faktorë emocionalë, si pikëllimi dhe humbja e një njeriu të afërt. / "The Conversation" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Berisha feston titullin kampion në Australi

MELBOURNE, 28 PRILL - Skuadra e Melbourne Cityt të premtën e ka festuar titullin kampion në A-League të Australisë. Melbourne luajti ndeshjen e raundit të fundit në ligë dhe mposhti 3 me 2 ekipin e WS

Wanderersit. Futbollisti i Kosovës, Valon Berisha, nuk ishte pjesë e kësaj ndeshje, por ishte në tribuna dhe në momentin kur skuadra u bë gati për ta ngritur trofeun, ai zbriti në fushë dhe festoi së

bashku me bashkëlojtarët e tij. Berisha u bë kosovari i dytë që ngriti një trofe të tillë në Australi, pas Besart Berishës, i cili këtë titull e fitoi katër herë gjatë karrierës me ekipet si Melbourne Victori dhe Western

United. Valon Berisha gjatë këtij sezoni luajti 24 ndeshje në ligë, shënoi një gol dhe bëri pesë asistime. Ky ishte viti i tij i parë në Australi dhe në fund të qershorit ai rikthehet në ekipin e Stade Reimsit në Francë.



Drita përballet me Ferizajn, Vavalis synon të debutojë me fitore

Drita sot (e shtunë) përballet me Ferizajn, ndërsa trajneri Akis Vavalis po synon të debutojë me fitore. "Jam i kënaqur me futbollistët për atë që kanë treguar në stërvitje. Janë vetëm tri ditë dhe nuk mund të bëjmë ndryshime të mëdha. E kemi studiuar kundërshtarin në çdo detaj. Jemi përgatitur për ndeshjen e rëndësishme. Së bashku me përkrahjen e tifozëve shkojmë për tri pikë ndaj Ferizajt", ka thënë Vavalis

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 PRILL - Trajneri i ri i Dritës, Akis Vavalis, po synon të debutojë me fitore në krye të gjilanasve. Skuadra e dytë në tabelën e klasifikimit, Drita, përballet të shtunën me skuadrën e Ferizaj, e cila shpesh ka ditur t'i befasojë skuadrat e tjera në këtë edicion të garave. Trajneri Vavalis është shprehur i kënaqur me paraqitjen e futbollistëve në stërvitje, ndërsa ka bërë me dije se pret fitore ndaj Ferizajt. "Jam i kënaqur me futbollistët për atë që kanë treguar në stërvitje. Janë vetëm

tri ditë dhe nuk mund të bëjmë ndryshime të mëdha. E kemi studiuar kundërshtarin në çdo detaj. Jemi përgatitur për ndeshjen e rëndësishme. Së bashku me përkrahjen e tifozëve shkojmë për tri pikë ndaj Ferizajt", ka thënë Vavalis. Në konferencën për medie, trajneri grek ka folur edhe për tifozët e klubit të Dritës, "Intelektualët". "Tifozët tanë, 'Intelektualët', s'i kam parë asnjëherë direkt nga stadiumi. Nga ajo që kam parë përmes televizorit, ata i japin mbështetje të madhe ekipit. Nesër jam i bindur se shtyrja e tyre do të jetë shumë e madhe,

sidomos në këto momente kur jemi në fund të kampionatit", ka shtuar ai. I pranishëm në konferencën për medie ishte edhe kapiteni i skuadrës së Dritës, Ardian Limani. Ky i fundit deklaroi se fitorja ndaj Prishtinës i ka motivuar shumë dhe ndaj Ferizajt presin tri pikët e radhës. "E dimë që pas fitores atmosfera është shumë e mirë. Fitorja ndaj Prishtinës na dha vetëbesim. Edhe të shtunën synojmë të bëjmë lojë edhe më të mirë. Ndaj Ferizajt nuk do të jetë e lehtë, por me ndihmën e tifozëve që pritet të jenë në numër të madh do ta japim



maksimumin për fitore", ka deklaruar Limani. Drita pozicionohet e dyta në renditjen tabelore me 60 pikë, një më pak se skuadra kryesuese. Në anën tjetër, Ferizaj i parafundit me 31 pikë dhe do të mundohet të nxjerrë rezultat pozitiv në mënyrë që ta vazhdojë rrugën për ta siguruar mbijetesën në elitë. Sot (e shtunë) zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes të Drenicës dhe Malishevës. Kuqezinjët e kanë humbur garën për mbijetesë dhe thajse janë të dorëzuar,

ndërsa malishevasit do të tentojnë ta marrin maksimumin e pikëve. Tri ndeshjet e tjera për këtë xhiro zhvillohen të dielën nga ora 15:00.

SUPERLIGA - Java 31
Të shtunën takohen:
15:00 Drita - Ferizaj
15:00 Drenica - Malisheva

Të dielën takohen:
15:00 Trepça '89 - Gjilani
15:00 Dukagjini - Ballkani
15:00 Prishtina - Llapi

Përfundoi edicioni i katërt i projektit 'Girls' Football Coaching Course'

PRISHTINË, 28 PRILL - Një festë futbollit dhe frymëzimi për vajzat e reja u organizua në ditën e fundit të edicionit të katërt "Girls' Football Coaching Course" në Kampin Nacional në Hajvali. Në këtë aktivitet, i cili organizohet tash e disa vjet në bashkëpunim të FFK-së me Federatën e Futbollit të Norvegjisë, 21 trajnere të grupmohave 18 deri 26 vjeçe morën njohuri praktike dhe teorike nga instruktorët norvegjezë për ta trajnuar në fushën e futbollit. Me uniforma të ngjyrave të ndryshme dhe lojërë të shumëllojshme, vajzat e reja u argëtuan përgjatë dy



orëve në këtë aktivitet dhe shijuan momente të lumtura dhe gëzimi. Përgjatë edicionit të katërt të "Girls' Football Coaching Course", 21 trajneret e përfshira kanë mësuar elementet bazë të të qenit lider

i një skuadre, sikur në fushë ashtu edhe në aspektin teorik, teksa në fund të kursit janë pajisur me diploma dhe me pajisje sportive që u duhen për të mbajtur stërvitje me vajzat e reja. Ky kurs edhe një herë dëshmon se sa e rëndësishme është mbështetja e vajzave dhe grave në sport dhe përmirësimi i tyre në fushën e trajnimit. Njëherësh edukimi i vazhdueshëm është një investim me rëndësi të madhe për futbollin e Kosovës, ngaqë trajneret e reja do të ndikojnë edhe në masivizimin e futbollit për vajza dhe ngritjen e nivelit të tij.

Qerimi: Jemi në rrugë të mirë

PRISHTINË, 28 PRILL - Selektori Bujar Qerimi ka vlerësuar paraqitjen e Përfaqësueses së Kosovës në hendboll ndaj Malit të Zi. Ai ka thënë se kanë kushtuar rastet e shumta të humbura. Qerimi ka thënë se Kosova është në rrugë të mirë. "Po na përsëritet kjo situatë, e kam thënë shumë herë. Ndoshta ma kanë zënë për të madhe, por kjo është e vërtetë. Në këtë fazë të garave ka portierë të mëdhenj. Në pjesën e parë kemi pasur shumë topa të humbur përballë portierit. Nuk kemi pasur probleme në sulm sa kemi pasur problem me realizim të golave. Në pjesën e dytë kemi aplikuar lojën me 7 lojtarë kundër 6 dhe është interesant. Ia kemi dalë



në pjesën e dytë. Ne jemi në rrugë të mirë, jemi kthyer. Ne duhet të përmirësohemi në finalizimin e rasteve, por koha e përgatitjeve për ndeshje është e shkurtër. Nesër e pasnesër do të kemi nga një stërvitje e më pas kemi lojën me Slloveninë. Megjithatë, jam i bindur se Kosova është në rrugë të mirë. Kjo lojë ka treguar se jemi një hap përpara", ka thënë selektori Bujar Qerimi.

Tare mund të ndahet me Lazion

ROMË, 28 PRILL - Igli Tare dhe Lazio nuk po e gjejnë gjuhën e përbashkët për vazhdimin e kontratës. Drejtori sportiv i lacialëve

po shikon mundësi të reja për vazhdimin e karrierës si drejtor sportiv. E ardhmja e ish-sulmuesit të Kombëtares së Shqipërisë

mund të jetë te Juventusit, që është në kërkim të një drejtori të ri sportiv. Në fakt, kjo nuk është hera e parë që emri i Tares lidhet me

klubin e Juventusit. Edhe në të kaluarën është aluduar për kalimin e tij te "Zonja e Vjetër", por në fund kishte mbetur në kryeqytet.



Skenderaj siguron finalen e madhe të 'play-off'-it

Skenderaj, 28 prill - Skenderaj ka siguruar finalen e madhe të "play-off"-it, të enjten mbrëma, pasi mposhti edhe në ndeshjen e dytë gjysmëfinale Fer Volleyn. Vashat e drejtuara nga trajneri

Ylli Kadriu triumfuan me rezultat 2:3 (18:25, 13:25, 25:19, 25:20, 13:15), pasi në ndeshjen e parë fituan me rezultat 3-0 (25-20, 25-14, 25-21). Kësaj radhe, skenderajaset hasën në

rezistencë shumë më të fortë nga nikoqiret, të cilat luftuan fuqishëm, duke arritur të barazonte rezultatin në 2-2 në sete, pasi e gjeti veten në disavantazh pas dy seteve të parë. Mirëpo, mysafiret nuk

lejuan befasi dhe fituan setin e pestë me dy pikë diferencë, për të siguruar finalen e madhe të "play-off"-it. Skenderaj, në finale, do të ndeshet me fituesin e



gjysmëfinale tjetër mes M-Technologie dhe Drita.

Pioli: Ndeshja Roma - Milan vlen gjashtë pikë

MILANO, 28 PRILL - Stefano Pioli të premten në konferencën për shtyp ka folur për ndeshjen ndaj Romës, e cila është vendimtare në Serinë A dhe zhvillohet të shtunën pasdite. Me shtatë ndeshje të mbetura për ta përfunduar sezonin, Milani aktualisht zë vendin e katërt në tabelën e Serisë A, ndërsa Roma është e pesta me pikë të barabarta. Pavarësisht se është kualifikuar në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve, Pioli e di se përballja e së shtunës në "Olimpico" është po aq e rëndësishme sa ajo. "Duhet t'u japim vazhdimësi paraqitjeve tona dhe të sigurohemi që ndeshja tjetër të jetë gjithmonë më e rëndësishme. Dhe kështu është: ndeshja e nesërme vlen dyfish dhe duhet ta përballojmë me shpirtin e duhur", ka thënë Pioli. "Ja vlen shumë. Ne kemi gjithnjë e më pak ndeshje për të luajtur. Kemi tru përplasje direkte. Sa më shumë pikë të marrim, aq më shumë shanse do të kemi për të përfunduar në top 4-she, që është synimi ynë më i madh. Jemi mirë. Ekziston dëshira për të pasur një fund të mirë të sezonit. Në ndeshjet e fundit do të vendoset



finalja e sezonit dhe ne duhet ta shohim veten si protagonistë. Ndeshjet duhet të luhen dhe të fitohen ende, por le t'i marrim ndeshjet një nga një, përndryshe humbasim energjinë", ka shtuar ai. "Performancat e fundit kanë qenë të mira. E dimë se çfarë të bëjmë në ndeshjet e rëndësishme, kështu që do të shkojmë në Romë me besim. Kemi cilësi për të bërë mirë". Pioli është i vetëdijshëm se Roma

do të jetë kundërshtarë e fortë dhe ka mbetur i impresionuar me paraqitjet e fundit të skuadrës së Jose Mourinhos, pavarësisht se humbi 3-1 kundër Atalantës fundjavën e kaluar. "Ne i dimë karakteristikat e tyre. Por, le të mos mendojmë shumë për rezultatin në fillim të sezonit. Duhet të jemi të kujdesshëm në ato situata ku Roma është e fortë, si në ndërprerje", ka deklaruar Pioli.

Bostoni ia del jashtë fushës, Celticsi kualifikohet në gjysmëfinale

BOSTON, 28 PRILL - Boston Celticsi është ekipi i fundit gjysmëfinalist në Konferencën e Lindjes. Skuadra e Celticsit triumfoi së fundmi 128-120 ndaj Atlanta Hawksit, duke fituar 4-2 serinë e takimeve çerekfinale. Një ndeshje me rivalitet shumicën e kohës, vendosur në fundin e saj. Atlanta nuk përfitoi nga faktori fushë për të fituar këtë ndeshje dhe të gjithë titullarët e saj realizuan mbi 10 pikë, ky Youngu me 30 pikë ishte më i miri për vendasit. Për Bostonin u dalluan Browni me 32 pikë e Tatum me 30, një dyshe që bëri dallimin në parket. Në gjysmëfinale Bostoni do të luajë ndaj Philadelphia dhe ka faktorin fushë në favor. Gjysmëfinalja tjetër në Lindje është ajo në mes të Miami Heatit



dhe New Yorkut. Në Perëndim janë ende për t'u përcaktuar dy ekipet e fundit gjysmëfinaliste. Çifti i parë është në mes të Denver

Nuggetsit dhe Phoenix Sunsit, ndërsa çifti tjetër do të dalë në mes të duelit Memphis - Lakers dhe Golden State - Sacramento.

SHKURT

Lëndohet Modriqi, mungon në disa ndeshje

Luka Modriqi është lënduar, raporton "El Chiringuito". Sipas saj, mesfushori kroat do të mungojë në ndeshjen ndaj Almerias dhe Real Sociedadit në ligë dhe ndaj Osasunas në finalen e Kupës së Mbretit. Modriqi është në dyshim edhe për ndeshjen e parë gjysmëfinale në Ligën e Kampionëve ndaj Manchester Cityt. Gjeniu kroat është aset mjaft i rëndësishëm i "Los Blancos" edhe këtë sezon dhe mungesa e tij në gjysmëfinalen e Ligës së Kampionëve do të ishte mjaft e madhe.

Mund të shtyhet finalja e FA Cup mes Cityt dhe Unitedit

Finalja e FA Cup mes Manchester Cityt dhe Manchester Unitedit, e planifikuar për të shtunën, më 3 qershor, në stadiumin "Wembley", mund të shtyhet. Federata Angleze e Futbollit po shqyrton hipotezën pas njoftimit nga "Aslef", Sindikata Britanike e Makinistëve, për grevë të transportit publik, në disa data, për të kërkuar rritjen e pagave të punëtorëve. Grevat janë planifikuar për të premten më 12 maj, të mërkurën më 31 maj dhe të shtunën më 3 qershor. Tifozët mund të hasin vështirësi të konsiderueshme për të shkuar në Londër nëse konfirmohet greva e transportit.

Bellinghami pëlqen kalimin në Real

Jude Bellingham është një nga lojtarët më të kërkuar në tregun e transferimeve, por mesfushori anglez ka vendosur për të ardhmen e tij. Sipas "AS", pas disa muajsh negociata me klubet e interesuara, Bellinghami ka zgjedhur Real Madridin. Pavarësisht dëshirës së lojtarit, kjo nuk është një marrëveshje e mbyllur pasi më parë presidenti Perez duhet të bindë edhe Borussia Dortmundin. Bosi i Realit nuk ka ndërmend të investojë më shumë se 120 milionë euro për kartonin e Bellinghamit, por Dortmundi kërkon të paktën edhe 20 milionë më shumë.

Xavi: Nuk e dimë nëse Messi do të rikthehet

Në deklaratat e tij para ndeshjes së Barcelonës ndaj Real Betisit, trajneri spanjoll Xavi Hernandez nuk përmendi asgjë të re për temën e argjentinasi Lionel Messi, duke theksuar se fitorja e kampionatit është e para. "Nuk e dimë nëse do të ndodhë rikthimi i Messit në Barcelonë. Jemi të fokusuar në ndeshjen kundër Betisit. Sapo ta fitojmë kampionatin do të flasim për këto çështje", ka thënë Xavi.

Skenderaj siguron finalen e madhe të 'play-off'-it



SKENDERAJ, 28 PRILL - Skenderaj ka siguruar finalen e madhe të "play-off"-it, të enjten mbrëma, pasi ka mposhtur edhe në ndeshjen e dytë

gjysmëfinale Fer Volleyn. Vashat e drejtuara nga trajneri Ylli Kadriu triumfuan me rezultat 2:3 (18:25, 13:25, 25:19, 25:20, 13:15), pasi në ndeshjen e parë fituan

me rezultat 3-0 (25-20, 25-14, 25-21). Kësaj radhe skenderajaset hasën në rezistencë shumë më të fortë nga nikoqiret, të cilat luftuan fuqishëm, duke arritur ta

barazojnë rezultatin në 2-2 në sete, pasi e gjetën veten në disavantazh pas dy seteve të para. Mirëpo, mysafiret nuk lejuan befasi dhe fituan setin e pestë me dy pikë dallim,

për ta siguruar finalen e madhe të "play-off"-it. Skenderaj në finale do të ndeshet me fituesin e gjysmëfinale tjetër mes M-Technologie dhe Dritës.

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINE SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
--	--	---

DREJTORIA E ARSIMIT
05n. 11-27734 datë 28-04 2023

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, nenit 35 të Ligjit për arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, UA nr.05/2021 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm), UA nr.08/2021, Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall këtë:

KONKURS
Për plotësimin e vendeve të lira të punës

- SHFMU "Shkëndija"-Suharekë**
 - Një mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës shqipe (zëvendësim i pushimit të lehonisë)
- SHFMU "Sadri Duhla"-Duhel**
 - Një mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës shqipe
- SHFMU "Edit Durham"-në Mushtisht**
 - Një mësimdhënës për mësim klasor (zëvendësim i pushimit të lehonisë)
- SHFMU "Dituria"-Samadrahë**
 - Një edukatore për paralelen parafillore (zëvendësim i pushimit të lehonisë)
- IP "Fluturat"-Suharekë**
 - Një edukatore

Kushtet: Për këto vende të lira të punës të shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit UA-MASHT nr.05/2021 dhe UA-MASHT nr.08/2021

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmi nga gjykata që nuk jeni nën hetime.
- Diploma e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje).
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet t'i kenë diplomën e nostrifikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim, (nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHTI (nëse ka)

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës.

Afati për pranimin e aplikacioneve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data **02.05.2023** deri më datë **16.05.2023**.

Për orarin e intervistimit do të informoheni në faqen zrytare të Komunës së Suharekës dhe tabelën e shpalljeve të DKA-së.

Drejtori i DKA-së
Remzi Bajselmani

Thirrja për aplikim (DHËNJE TË OFERTËS)



"TIKI TH" SH.P.K. me numer Unik:812019398 me seli fshati Muqiverce p.n. Komuna Kamenice me pronar **ARSIM THAQI**, po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për **mallrat/punët/shërbime** këshilluese si në vijim: për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre **Makinerive**, **Paisjeve Bujqësore dhe energji solare:**

1. Traktor 100 HP 4x4 me kabin, klim ,
2. Mbjellose Gruri me rende 3 m me plehrim
3. Rotoballer 120x120
4. Mulli me Mikser 500 kg/h
5. Mbjellose mistri pneumatike
6. Pijatore 28 disqe
7. Sterpikese 600 litra
8. Pllug 4 rendor Alpler
9. Rimorkio 8 ton
10. Panele Solare 3 kw

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek **"TIKI TH" SH.P.K.** - **ARSIM THAQI** (Përfituesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë **(5 ditë nga data e publikimit)**

Afati i dorëzimit të Ofertave **10 ditë nga data e pranimit të ftesave** për kuotim, ofertat dorëzohen në Adresën: fshati Muqiverce p.n. Komuna Kamenice
Për Informata Shtesë tel: **+383 44 244 185** dhe në email adresën: **d.morina90@hotmail.com**

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINE SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
--	--	---

DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE
05 br. 11-27734 od 28.04-2023 godine

Na osnovu člana 8 Zakona o radu br.03/L-212, člana 35 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u republiku Kosova br.04/L-032, člana 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo br.03/L-068, AUbr.05/2021, AUbr.08/2021 (Normariva u stručnim kadrovima opšteg obrazovanja), Administrativnog uputstva br.07/2017 o regulisanju procedura za osnivanje radnog mesta u javnom sektoru, Opština direkcija za obrazovanje objavljuje:

KONKURS
Za popunu slobodnih mesta

- OSNŠ "Shkëndija"- Suva Reka**
 - Jedan nastavnik/ca za predmet albanskog jezika (zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)
- OSNŠ "Sadri Duhla"-Dule**
 - Jedan nastavnik/ca za predmet albanskog jezika
- OSNŠ "Edit Durham"-Muštište**
 - Jedan nastavnik/ca za razredu nastavu (zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)
- OSNŠ "Dituria"-Samadrade**
 - Jedan nastavnik/ca za predškolskog obrazovanje (zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)
- Dečji vrtić "Fluturat"-Suva Reka**
 - Jedan vaspitačicu

Uslovi: Za ova slobodna radna mesta obavljena na konkursu potrebna je odgovarajuća stručna sprema prema normative AU MONT br.05/2021, AU br.08/2021.

Dokumentacija potrebna za konkurs:

- Obrazac (prijava) kokandidat popunjava
- Ekstrakt rođenja
- Lična karta (fotokopija)
- Potvrda za obuke akreditovane od MONT-a (ako ga ima)
- Dokaz od sud da nije pod istragom
- Dokaz o Radnom iskustvu u obrazovanju (ako ga ima)
- Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju imati nostrifikovane diplome MONT-a

Kopletirane dokumenti se dostavljaju u fotokopirano, dok će se originalni dokumenti podstavljavati u intervju. Komisija neće razmatrati nepotpune i dokumenta prispela nakon isteka roka. Prijave se primaju i predaju u Prijemnu Kancelariju u Opštine Suva Reka.

Konkurs ostaje otvoren 15 (petnaest) dana od 02.05.2023 do 16.05.2023.
Oraspedu intervju bičete obavješteni na web stranici Opštine Suva Reka i oglasnoj table ODO.

Direktor Obrazovanje
Remzi Bajselmani

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Rozana Nokaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së 10 të shkollës së mesme ekonomike "Kadri Kusari".

- Ardian Muharremi B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit D.P.H. caffè bar "Te Ardiani" me NRB 810554635.

Gzim Kalludra shpall të pavlefshme 3 dëftesat e shkollës së mesme Teknike "Arkitekt Sinani".

Fazile Emini, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Xheladin Deda".

Flamur Kurti shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Xheladin Deda".

Remo co ing SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 810549008.

Shkodran Bllaca shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I - IX sh.f.m.u. "Abdyll Frashëri" Prizren.

Xhylnaze Nesimi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII sh.f.m.u. "28 Nëntori" Brodosane.

Emil Ajradinaj shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

Kushtrim Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

Çlirim Qarri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII dhe diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

Rina Brovina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën ekl. X, XI, XII dhe diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

